

FAMILJES KUJDESTARE SHTETI I SIGURON:

- 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj për shpenzimet e ushqimit të një fëmije në kujdestari;
- 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për shpenzimet e ushqimit nëse fëmija është me aftësi të kufizuara;
- Gjithashtu familja kujdestare përfiton nga shteti 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit për veshmbathjen, 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit për shpenzime të tjera dhe 5 000 (pesë mijë) lekë në vit për arsimimin.

7 KUJDESTARIA NE INSTITUCIONET E PERKUJDESJES VENDOSËT:

- Kur i mituri nuk ka të afërm të njohur ose të afte për të ushtruar detyrën e kujdestarit;
- Kujdestaria i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të licencuar për përkujdesjen e fëmijëve;
- Drejtuesi i institucionit i delegon njërit nga punonjësve të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit;



KONTAKTONI TLAS:

TLAS ofron shërbim ligjor për çështje të së drejtës civile, administrative, familjare, të punës dhe të shkëlqes së të drejtave të njeriut.

**04 2258442;
0692093731;
tlas@tlas.org.al**

**Nga e HËNA në të PREMTE
9:00 - 14:00**



**ADRESA E TLAS:
Bulevardi Bajram Curri,
Pallatet Agimi,
Shkalla 18, Ap.322,
Tiranë, Shqipëri
Kutia postare nr. 69**

FËMIJËT E MITUR KANË NEVOJË PËR KUJDESTAR



www.tlas.org.al





① KUSH ESHTË KUJDESTAR I FEMIJES

- Prindërit janë automatikisht kujdestarët ligjorë të fëmijës së tyre;
- Prindërit janë kujdestarë pavarësisht faktit nëse janë të martuar apo jo;
- Prindërit që nuk janë ligjërisht martuar dhe kanë mosmarrëveshje e zgjidhin me vendim gjyqësor të drejtën e kujdesit për fëmijën.

② DETYRAT E KUJDESTARIT:

- Të ruaj dhe të kujdeset për fëmijën;
- Të marrë vendime për edukimin, shëndetin dhe mirëqënien e fëmijës;
- Fëmija ka nevojë për kujdestar deri në moshën 18 vjeç;
- Kur fëmija ka paaftësi fizike apo mendore ka nevojë për kujdestar edhe pasi ka mbushur moshën 18 vjeç;

KONTAKTONI TLAS:
04 2258442; 0692093731;

③ RASTET KUR DUHET TË ÇAKTOHEN KUJDESTARË LIGJORE TË TJERË

- Kur prindërit e fëmijës nuk ushtrojnë përgjegjësinë prindërore;
- Kur të dy prindërit kanë vdekur;
- Kur prindërit nuk njihen;
- Kur prindërit janë shpallur si të pagjetur;
- Kur prindërit u është hequr zotësia për të vepruar;
- Kur gjykata vendos për çdo shkak tjetër që cënon interesin e fëmijës;

④ KUSH MUND TE JENË KUJDESTARË LIGJORE TE TJERE

- Persona të tjerë kujdestar ligjor për të miturin caktohen vetëm me vendim gjyqësor;
- Kujdestar Ligjor mund të jenë gjyshërit, të afërmit dhe persona që kujdesen për fëmijën;
- Familjet kujdestare;
- Istitucionet e përkujdesjes për të mitur;



KONTAKTONI TLAS:
04 2258442; 0692093731;

⑤ NUK MUND TE ÇAKTOHET KUJDESTAR LIGJOR

PERSONI QE:

- Është vetë në kujdestari;
- Ka konflikt interesash me të miturin;
- I është hequr më parë përgjegjësia prindërore, ose kujdestaria në një rast tjetër;
- Është në kohën e vuajtjes së dënimit me burg;
- Ka mbushur moshën 65 vjeç;
- Gjendja shëndetësore nuk e lejon të ushtrojë me lehtësi kujdestarinë;



⑥ ÇAKTIMI I NJE FAMILJEJE KUJDESTARE

VENDIMI Nr. 89, 26.01.2012 LEGJITIMON FUNKSIONIMIN E FAMILJES KUJDESTARE

- Komisioni multidisiplinar i kujdestarisë i ngritur pranë bashkisë vlerëson familjen aplikuese nëse plotëson ose jo kushtet për të qënë kujdestare;
- Viziton banesën, verifikon kushtet e jetesës, interviston gjithë antarët e familjes;
- Interviston refreuesit e familjes aplikuese;
- Interviston specialistë të tjerë si psikologë, policë, përfaqësues të organeve të pushtetit vendor, punëdhënës të bashkëshortëve, përfaqësues të arsimit dhe komunitetit;
- Vlerësimi i komisionit multidisiplinar i përcillet gjykatës së rrethit përkatës;
- Gjykata vendos përfundimisht për pranimin e familjes aplikuese si familje kujdestare.